



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1148 prot.

Vlorë, më 24 . 01 2024

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë, \_\_\_\_\_ 2024

**“MBI KRIJIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR MEDALJET DHE TITUJT VENDOR TË NDERIT NË BASHKINË VLORË”.**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, neni 9.1 pika 1.1/a,b, c dhe 1.7/a, Neni 54 pika k dhe m, në Ligjin nr.112/2013 datë 04.04.2013 “Për Deklaratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt e nderit vendorë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 17, në VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë, si dhe në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_

**VENDOSI:**

1. Të ngrihet Komisioni Këshillimor për Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit të Bashkisë, i përbërë nga :
  - Kreshnik Çipi
  - Astrit Aliaj
  - Sokol Kuçaj
  - Efrosina Papa
  - Bardhosh Gaçe
2. Ky Projekt-Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 55 pika 6.

Konceptoi: *S.Kalemi*

Miratoi: *D.Demiri*

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 1148 prot.

Vlorë, më 24.01 2024

**RELACION**

Mbi Projekt-Vendimin “Për ngritjen e Komisionit Këshillimor për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Vlorë“

**PARA KËSHILLIT TË BASHKISË**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Projekt Vendimi që ju paraqesim është një detyrim ligjor që rrjedh nga Ligji Nr.112/2013, datë 04.04.2013 “ Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt e nderit vendorë në Republikën e Shqipërisë “ si dhe V.K.M –së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisioneve Këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë “, nëpërmjet të cilave ligjvënësi ka përcaktuar detyrimin e ngritjes së një Komisioni Këshillimor pranë Këshillit të Bashkisë , i cili është organi që jep tituj nderi dhe medalje . Përbërja e këtij Komisioni Këshillimor , bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara , miratohet nga Këshilli i Bashkisë dhe në përbërjen e tij duhet të jenë 5 anëtarë , ekspert të fushave të ndryshme por edhe punonjës në marrëdhënie pune me Bashkinë. Komisioni Këshillimor, sipas ligjit, administron propozimet për tituj nderi , i vlerëson ato dhe i paraqet Këshillit të Bashkisë mendimin e tij rast pas rasti , të shoqëruar me relacionin përkatës.

Vendimet e këtij Komisioni të cilët merren me shumicë votash janë një ndihmë për vendimarrjen e Këshillit të Bashkisë, pasi këta anëtarë janë ekspert të fushave të ndryshme dhe paraprakisht studiojnë dokumentacionin përkatës të subjekteve që propozojnë dhënien e titujve të nderit dhe medaljeve.

Për rrjedhojë, vlerësojmë se duhet të zgjidhen persona të spikatur por edhe që janë të angazhuar dhe të përgjegjshëm për detyrat e ngarkuara .

Duke paraqitur këtë Projekt Vendim sjellim në vëmendjen e Këshillit të Bashkisë faktin se aktualisht në protokollin e Bashkisë janë të administruara shume kërkesa dhe propozime për dhënie tituj nderi, emërtime rrugësh, sheshesh etj, kërkesa të cilat i janë përcjellë Këshillit të Bashkisë .

Kjo e bën të domosdoshëm krijimin e Komisionit Këshillimor për të vijuar procedurat e mëtejshme të vendimarrjes nga Këshilli i Bashkisë dhe për ti dhënë përgjigje përfundimtare të interesuarve .

Në përbërjen e Komisionit kemi propozuar edhe punonjës të Bashkisë pasi puna e këtij Komisioni nuk është vetëm çështje e një mbledhje komisioni sic mund të mendohet por ky komision do të ketë edhe korrespondenca me institucione të tjera.

Rrjedhimisht ndjekja e gjithë procedurës së parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara kërkon një angazhim në kohë por edhe bashkëveprim me Administratën e Bashkisë .

Parë në këtë këndvështrim përbërjen e Komisionit sipas Projekt-Vendimit që ju paraqesim vlerësojmë se i përmbush kërkesat e ligjit si dhe pritshmëritë e Këshillit të Bashkisë në funksion të një vendimarrje e cila duhet të jetë e pranueshme edhe nga opinioni publik i qytetit.

Në këto kushte, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë miratimin e këtij Projekt-Vendimi , i cili do ti hap rrugë gjithashtu edhe përfundimit të procesit të emërimit të rrugëve, shesheve të paemërtuar si dhe për rastet kur kanë nevojë për saktësimet përkatëse, sikurse është konstatuar në disa raste.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi: *S.Kalemi*

Miratoi: *D.Demiri*

**KRYETARI**

**Ermal Dredha**

